

# RELACION

## PËR PROJEKTLIGJIN

### PËR

#### **DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7895, DATË 27.1.1995 “KODI PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

#### **I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Procesi i përafrimit të legjislacionit shqiptar me *acquis communautaire* përbën një nga prioritetet themelore të integritetit evropian të Shqipërisë. Në fushën penale, ky proces ka rëndësi të dyfishtë: (i) rrit sigurinë juridike dhe harmonizon standardet e mbrojtjes së të drejtave themelore me ato të Bashkimit Evropian; (ii) fuqizon besueshmërinë e sistemit tonë penal në luftën kundër kriminalitetit të organizuar, korrupsionit, pastrimit të parave, terrorizmit dhe formave të tjera të kriminalitetit transnacional.

Ky projektligj synon përafrimin e Kodit Penal me shtatë akte kryesore të Bashkimit Evropian, mbi politikën penale të BE-së në luftën kundër krimit të organizuar dhe në mbrojtjen e viktimave.

Në kontekstin e procesit të anëtarësimit në BE, sipas Kapitullit 24: Drejtësia, Liria dhe Siguria, Shqipëria duhet të transpozojë - ndër të tjera - *acquis* të BE-së në lidhje me fushat e pastrimit të parave, terrorizmit, trafikut të drogërave, viktimave e trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjes së tyre, abuzimit seksual dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografisë së fëmijëve.

Këto akte ligjore të BE-së duhet të transpozohen, ndër të tjera, edhe në Kodin Penal. Përafrimi i këtyre akteve vjen në vazhden e përmbushjes së detyrimeve të ndërmarra në kuadër të piketave të ndërmjetme të cilat duhet të përmbushën brenda vitit 2025.

Përmes këtyre ndryshimeve synohet të arrihen objektivat e mëposhtme:

- Përmbushja e piketave të ndërmjetme në kuadër të integritetit të vendit në BE;
- Adresimi i boshllëqeve, rasteve të transpozimit të paplotë ose të pasaktë në Kodin Penal në fuqi;

- Sigurimi i transpozimit të plotë të Kodit Penal me shtatë aktet ligjore të BE-së të lartpërmendura.

Ndërkohë pjesë e projektligjit janë edhe ndryshimet që propozohen të kryhen në kuadër të marrjes së masave të menjëhershme për adresimin e fenomenëve të ndërtimeve pa leje, zënies së hapësirave publike, si dhe të problematikave me zjarret të hasura së fundmi. Këto ndryshime synojnë që të ndëshkojnë dhe parandalojnë veprat penale që rrjedhin si pasojë e shkeljes së legjislacionit për ndërtimin, si dhe të mbrojnë pronë private dhe publike, si dhe pasuritë kombëtare nga zjarret.

Ky projektligj synon të forcojë mbrojtjen e territorit dhe pasurive kombëtare përmes ndërhyrjes në Kodin Penal lidhur me ndërtimet e paligjshme, zënien e tokave dhe zjarrvëniet. Qëllimi është të ndëshkohen me rreptësi më të lartë veprimet që dëmtojnë mjedisin, pronën publike e private, trashëgiminë kulturore dhe infrastrukturën kritike, duke rritur njëkohësisht efektin parandalues të ligjit penal.

Objektivat kryesore që synohen janë:

- Rritja e standardeve të mbrojtjes së pasurisë publike dhe private nga ndërtimet pa leje dhe zënia e tokave;
- Forcimi i masave ndëshkuese kundër zjarrvënieve, veçanërisht kur kryhen në kushte që shtojnë rrezikun e përhapjes ose në zona të mbrojtura;
- Parandalimi i spekulimeve për ndryshimin e destinacionit të tokës pas zjarreve në pyje dhe mbrojtja afatgjatë e hapësirave të gjelbra;
- Rritja e integritetit të administratës publike duke sanksionuar më rëndë rastet kur funksionarët publikë përfshihen në ndërtim pa leje apo në zënien e tokave.

Nga ana tjetër, nuk ka mbetur pa u adresuar dhe një tjetër fenomen shqetësues siç është ai i parkimit në rresht të dytë, ose i njohur si parkimi i dyfishtë. Ndër të tjera, procesi i përmirësimit të Kodit Penal përbën një nga mekanizmat themelore për rritjen e sigurisë publike. Ky projektligj ka rëndësi të dyfishtë pasi rrit sigurinë dhe qartësinë juridike për të gjithë qytetarët në lidhje me përdorimin e hapësirave të qarkullimit, si dhe fuqizon sistemin penal në mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të qytetarëve, duke adresuar veprime që pengojnë qarkullimin e mjeteve të emergjencës dhe rrezikojnë sigurinë publike.

Ky projektligj synon të përfshijë në Kodin Penal veprën e parkimit të mjetit në rresht të dytë, përveç rasteve të specifikuara, kur ky veprim pengon qartë lëvizjen e automjeteve në shërbim të policisë, zjarrfikësve, autoambulancave ose shërbimeve

të tjera të institucioneve publike, duke shkaktuar bllokim total të rrugës ose pengesë serioze për këmbësorët.

Në kontekstin e përmirësimit të sigurisë rrugore dhe të efektivitetit të shërbimeve emergjente, ky projektakt ka për qëllim të sanksionojë veprimet që rrezikojnë drejtpërdrejt jetën dhe shëndetin e qytetarëve, duke rritur njëkohësisht efektin parandalues të ligjit penal.

Objektivat kryesore që synohen të arrihen:

- Rritja e sigurisë rrugore dhe mbrojtja e jetës së qytetarëve duke ndëshkuar parkimin në rresht të dytë që pengon qarkullimin e mjeteve emergjente;
- Parandalimi i bllokimeve totale të rrugëve dhe pengesave serioze për këmbësorët, duke mbështetur lëvizjen e lirë dhe të sigurt të qytetarëve;
- Forcimi i efektit parandalues të ligjit penal në mënyrë që qytetarët të respektojnë hapësirat e qarkullimit dhe të kontribuojnë në sigurinë publike;
- Sigurimi i një kuadri ligjor të qartë dhe të efektshëm për institucionet e zbatimit të ligjit, duke mundësuar ndërhyrje të shpejta dhe të efektshme në situata emergjente.

## **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Ky projektligj nuk është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve që i paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2025, por është në përputhje me objektivat e qeverisë për integrimin e vendit në BE, si dhe me Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024–2030, të miratuar me VKM nr. 787, datë 18.12.2024, si dhe me strategjitë e tjera të fushave përkatëse të miratuara nga Këshilli i Ministrave.

Gjithashtu, ky projektligj është në përputhje me objektivat e qeverisë për një zhvillim të qëndrueshëm të territorit, si dhe për mbrojtjen e pasurisë.

## **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Nisma për ndryshimin e Kodit Penal është ndërmarrë në kuadër të përafrimit të legjislacionit kombëtar në fushat e pastrimit të parave, luftën ndaj terrorizmit, trafikut të paligjshëm të drogave, trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjes së viktimave të tij, abuzimit seksual dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografisë së fëmijëve. Në angazhimet e ndërmarra nga Republika e Shqipërisë, përafrimi i këtyre akteve është parashikuar të kryhet brenda vitit 2025, prandaj edhe nisma për përafrimin e tyre po ndërmerret pavarësisht angazhimit të Ministrisë së Drejtësisë për hartimin e një Kodi të ri Penal.

Aktet e BE që përafrohen në Kodin Penal janë si më poshtë:

1. Vendimi Kuadër i Këshillit 2001/500/JHA i 26 qershorit 2001 mbi pastrimin e parave, identifikimin, gjurmimin, ngrirjen, sekuestrimin dhe konfiskimin e instrumenteve dhe të ardhurave nga krimi;
2. Vendimi Kuadër i Këshillit 2004/757/JHA i 25 tetorit 2004 që përcakton dispozitat minimale mbi elementët përbërës të veprave penale dhe dënimet në fushën e trafikimit të paligjshëm të drogës;
3. Direktiva 2011/36/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 5 prillit 2011 për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tij, dhe që zëvendëson Vendimin Kornizë të Këshillit 2002/629/JHA;
4. Direktiva 2011/93/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 13 dhjetorit 2011 për luftimin e abuzimit seksual dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografisë së fëmijëve, dhe që zëvendëson Vendimin Kornizë të Këshillit 2004/68/JHA;
5. Direktiva (BE) 2015/849 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 20 majit 2015 mbi parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit, që ndryshon Rregulloren (BE) nr. 648/2012 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, dhe shfuqizon Direktivën 2005/60/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe Direktivën e Komisionit 2006/70/KE;
6. Direktiva (BE) 2017/541 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 15 marsit 2017 për luftën kundër terrorizmit dhe zëvendësimin e Vendimit Kuadër të Këshillit 2002/475/JHA dhe ndryshimin e Vendimit të Këshillit 2005/671/JHA;
7. Direktiva (BE) 2018/1673 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 23 tetorit 2018 për luftën kundër pastrimit të parave me anë të ligjit penal.

## **1. Transpozimi i *acquis* përkatës për pastrimin e parave**

Tre nga aktet ligjore të BE-së të lartpërmendura përcaktojnë rregulla në fushën e luftimit të pastrimit të parave:

---

Relacion shpjegues për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”.

- Vendimi Kuadër i Këshillit 2001/500/JHA i 26 qershorit 2001 mbi pastrimin e parave, identifikimin, gjurmimin, ngrirjen, sekuestrimin dhe konfiskimin e instrumenteve dhe të ardhurave nga krimi;
- Direktiva (BE) 2015/849 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 20 majit 2015 mbi parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit, që ndryshon Rregulloren (BE) nr. 648/2012 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, dhe shfuqizon Direktivën 2005/60/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe Direktivën e Komisionit 2006/70/KE; dhe,
- Direktiva (BE) 2018/1673 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 23 tetorit 2018 për luftën kundër pastrimit të parave me anë të ligjit penal..

Kërkesat e Vendimit Kuadër të Këshillit 2001/500/JHA, të cilat duhet të transpozohen në Kodin Penal, janë transpozuar tashmë. Vetëm dy dispozita të Direktivës (BE) 2015/849 duhet të transpozohen në Kodin Penal, ndërsa dispozitat e tjera janë transpozuar në ligjet përkatëse sektoriale. Këto dy dispozita të Direktivës (BE) 2015/849, të cilat duhet të transpozohen në Kodin Penal, përsëriten pothuajse fjalë për fjalë në Direktivën (BE) 2018/1673 për luftimin e pastrimit të parave me anë të ligjit penal.

Direktiva (BE) 2018/1673 synon të kriminalizojë pastrimin e parave kur ajo kryhet me dashje dhe me dijeninë se pasuria vjen nga aktivitet kriminal. Ajo gjithashtu u lejon Shteteve Anëtare të kriminalizojnë pastrimin e parave kur shkelësi dyshonte ose duhej ta dinte se pasuria vinte nga aktivitet kriminal.

Për transpozimin e këtyre akteve ligjore të BE-së, Kodi Penal aktual ka një vendim politik themelor, për të mos kufizuar veprimet e pastrimit të parave në veprat penale të listuara në përkufizimin e 'aktivitetit kriminal' në Nenin 2(1) të Direktivës (BE) 2018/1673. Prandaj, në Shqipëri çdo veprim i pastrimit të parave, pavarësisht nga vendi ku rrjedhin të ardhurat, mund të përbëjë një vepër penale të pastrimit të parave. Këto ndryshime nuk e ndryshojnë këtë qasje.

Amendamentet plotësojnë boshllëqet e mbetura të përafrimit ose rastet e përafrimit të pasaktë, veçanërisht në lidhje me aspektet e mëposhtme (dispozitat të cilat synojnë përafrimin e Acquis të BE-së, janë në kllapa):

- Zgjerimi dhe përafrimi i përkufizimeve të veprave penale të pastrimit të parave me elementët/formulimet siç sugjerohet nga Direktiva/Vendimi Kuadër (Neni 287)

- Rritja e afatit të burgimit për vepra të caktuara penale të pastrimit të parave për të përmbushur pragjet minimale të kërkuara nga aktet ligjore të BE-së (Neni 149/a, Neni 149/b, Neni 180/a)
- Specifikimi i veprës penale të trafikimit të mallrave të vjedhura (Neni 141/a).
- Futja e një dispozite mbi kriminalizimin e mashtrimit që ndikon në interesat financiare të BE-së (Neni 143/a/8).
- Futja e veprave penale të korrupsionit që lidhen me zyrtarët e BE-së, zyrtarët e lartë, gjyqtarët e GJED-së dhe Gjykatës Evropiane të Auditorëve, të cilat do të hyjnë në fuqi pas bërjes pjesë së të drejtës së brendshme të Republikës së Shqipërisë të Konventës për luftën kundër korrupsionit që përfshin zyrtarë të Komuniteteve Evropiane ose zyrtarë të Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian (Neni 244/a; Neni 245/a; Neni 259/b; Neni 260/a; Neni 319/a/1; Neni 319/d/1)

## **2. Transpozimi i acquis-it në lidhje me trafikimin e drogës**

Vendimi Kuadër i Këshillit 2004/757/JHA i 25 tetorit 2004 që përcakton dispozitat minimale mbi elementët përbërës të veprave penale dhe dënimet në fushën e trafikimit të paligjshëm të drogës kërkon që çdo vend i BE-së të marrë masat e nevojshme për të penalizuar të gjitha veprimet e qëllimshme që lidhen me trafikimin e drogës dhe prekursorëve.

Vendimi Kuadër e përcakton një 'drogë' si një substancë të mbuluar nga Konventa e Vetme e Kombeve të Bashkuara (OKB) e vitit 1961 mbi Drogat Narkotike, të ndryshuar nga Protokolli i vitit 1972, ose nga Konventa e OKB-së e vitit 1971 mbi Substancat Psikotrope.

Veprat e lidhura me trafikimin e drogës përfshijnë prodhimin, fabrikimin, nxjerrjen, shitjen, transportin, importimin dhe eksportimin. Posedimi dhe blerja me qëllim përfshirjen në aktivitete të lidhura me trafikimin e drogës merren gjithashtu në konsideratë, njësoj si prodhimi, transporti dhe shpërndarja e prekursorëve. Nxitja për trafikimin e drogës, ndihma dhe inkurajimi i një aktiviteti të tillë, dhe përpjekja për trafikimin e drogës konsiderohen gjithashtu si vepra penale.

Megjithatë, ky Vendim Kuadër nuk mbulon aktivitetet që lidhen me trafikimin e drogës për konsum personal.

Amendamentet plotësojnë boshllëqet e mbetura të përafrimit ose rastet e përafrimit të pasaktë, veçanërisht në lidhje me aspektet e mëposhtme (dispozitat të cilat synojnë përafrimin e kërkesave të aktit të BE-së, janë në kllapa):

- Zgjerimi i përkufizimit aktual të veprave penale që lidhen me trafikimin e paligjshëm të drogës në ofrim, ndërmjetësim, dërgim në tranzit, dorëzim në çdo formë, transport dhe shpërndarje duke e përafruar atë me formulimin e Vendimit Kuadër (Neni 283; Neni 284/ç; Neni 287)
- Futja e sanksioneve për rastet që përfshijnë sasi të konsiderueshme narkotikësh dhe substancash psikotrope dhe narkotike që shkaktojnë ose kanë shkaktuar dëme serioze në shëndetin e personave (Neni 283; Neni 283/a; Neni 284; Neni 284/c).

### **3. Përafrimi i *acquis-it* në lidhje me luftimin e abuzimit seksual dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografisë së fëmijëve;**

Direktiva 2011/93/BE e 13 dhjetorit 2011 për luftimin e abuzimit seksual dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografisë së fëmijëve, dhe zëvendësimin e Vendimit Kornizë të Këshillit 2004/68/JHA me qëllim lehtësimin e ndjekjes penale të shkelësve në veçanti:

- kriminalizon një gamë të gjerë situatash të abuzimit dhe shfrytëzimit seksual (20 vepra penale dhe tentativa);
- prezanton nivele të rritura të dënimeve. Nivelet maksimale të përcaktuara nga legjislacioni kombëtar nuk duhet të jenë më të ulëta se nivelet që shkojnë nga 1 deri në 10 vjet burg, varësisht nga serioziteti i veprës penale. Duhet të merren në konsideratë edhe një numër rrethanash rënduese;
- zgjat afatin e parashkrimit pasi viktimat të ketë arritur statusin e të rriturit;
- prezanton juridiksionin ekstraterritorial për shkelësit që janë shtetas, në mënyrë që ata të mund të ndiqen penalisht edhe në vendin e tyre për krimet që kryejnë jashtë vendit.

Amendamentet plotësojnë boshllëqet e mbetura të përafrimit ose rastet e përafrimit të pasaktë, veçanërisht në lidhje me aspektet e mëposhtme (dispozitat të cilat synojnë përafrimin e kërkesave të aktit të BE-së, janë në kllapa):

- Futja e ndalimit të përkohshëm ose të përhershëm të ushtrimit të aktiviteteve profesionale që përfshijnë kontakt të drejtpërdrejtë dhe të rregullt me fëmijë të mitur, si një dënim shtesë së bashku me atë kryesor (Neni 30)

- Futja e një mbrojtjeje që siguron që fëmijët që janë viktima të veprave penale si pornografia e fëmijëve, prostitucioni ose shfrytëzimi nuk mund të ndiqen penalisht ose të ndëshkohen për përfshirjen e tyre (Neni 52/a)
- Forcimi i kriminalizimit të akteve seksuale me të mitur, rritja e niveleve të sanksioneve dhe sqarimi i rrethanave rënduese (p.sh., abuzimi i besimit, autoritetit prindëror ose shfrytëzimi i situatave vulnerabël) (Neni 100, Neni 101, Neni 108, Neni 108/b)
- Specifikimi i kushtit të kriminalizimit të dyfishtë për veprat penale që lidhen me abuzimin seksual të të miturve, shfrytëzimin seksual të të miturve, shfrytëzimin e prostitucionit të të miturve, pornografinë dhe pornografinë e fëmijëve (Neni 6)
- Kriminalizimi i përfshirjes për qëllime seksuale të një të mituri për të dëshmuar aktivitete seksuale, edhe pa pasur nevojë të marrë pjesë (Neni 108)
- Shtimi i veprave penale që lidhen me shkaktimin, për qëllime seksuale, të një fëmije që nuk ka arritur moshën e pjekurisë seksuale për të dëshmuar abuzim seksual, përfshirjen në aktivitete seksuale me një fëmijë, shkaktimin ose rekrutimin e një fëmije për të marrë pjesë në shfaqje pornografike, ose përfitimin nga ose shfrytëzimin ndryshe të një fëmije për qëllime të tilla, dhe të tjera (Neni 114/a/1; Neni 117).

#### **4. Transpozimi i acquis-it në lidhje me luftën kundër terrorizmit**

Direktiva (BE) 2017/541 për luftën kundër terrorizmit ofron një listë të plotë të veprave penale të rënda që vendet e BE-së duhet t'i klasifikojnë si vepra penale terroriste në ligjin e tyre kombëtar kur ato kryhen ose ekziston një kërcënim për t'i kryer ato për një qëllim të caktuar terrorist.

Qëllimet terroriste përkthehen si çdonjëri nga qëllimet si vijon:

- frikësimi serioz i një popullsie;
- detyrimi i padrejtë i një qeverie ose një organizate ndërkombëtare për të kryer ose për t'u përmbajtur nga kryerja e ndonjë akti;
- destabilizimi serioz ose shkatërrimi i strukturave themelore politike, kushtetuese, ekonomike ose sociale të një vendi ose të një organizate ndërkombëtare.

Lista e veprave penale terroriste të cilat vendet e BE-së duhet t'i ndëshkojnë gjithashtu si vepra penale, edhe nëse një vepër penale terroriste nuk është kryer në mënyrë efektive, zgjerohet për të mbuluar:

- veprat penale që lidhen me një grup terrorist (domethënë, drejtimin e një grupi të tillë ose pjesëmarrjen me vetëdije në aktivitetet e tij) kur kryhen me dashje, dhe

- veprat penale që lidhen me aktivitetet terroriste. Këto përfshijnë:
- shpërndarjen, qoftë online apo offline, të një mesazhi me qëllim nxitjen e një vepre penale terroriste, për shembull duke lavdëruar aktet terroriste;
- nxitjen dhe rekrutimin e një personi tjetër për të kryer një vepër penale terroriste;
- ofrimin ose marrjen e trajnimit për qëllime terroriste, për shembull, në prodhimin ose përdorimin e eksplozivëve, armëve të zjarrit ose substancave të rrezikshme;
- udhëtimin brenda, jashtë ose drejt BE-së për qëllime terrorizmi, për shembull për të marrë pjesë në aktivitetet e një grupi terrorist ose për të kryer një sulm terrorist;
- organizimin dhe lehtësimin e udhëtimeve të tilla, duke përfshirë mbështetjen logjistike ose materiale, siç janë blerja e biletave ose planifikimi i itinerarit;
- ofrimin ose mbledhjen e fondeve me qëllim që ato të përdoren ose duke ditur se ato do të përdoren për të kryer vepra penale terroriste.

Amendamentet plotësojnë boshllëqet e mbetura të përafrimit ose rastet e përafrimit të pasaktë, veçanërisht në lidhje me aspektet e mëposhtme (dispozitat të cilat synojnë përafrimin e kërkesave të aktit të BE-së, janë në kllapa):

- Specifikimi i juridiksionit në lidhje me veprat penale të terrorizmit në rast të refuzimit të kërkesës për ekstradim (Neni 7/b)
- Përmirësimi i përshkrimit të sjelljeve në lidhje me veprat penale terroriste me qëllim, rekrutimin për terroristë dhe trajnimin për terrorizëm dhe vepra të tjera penale që lidhen me aktivitetet terroriste (Neni 230; Neni 231)
- Shtimi i një vepre penale që lidhet me pjesëmarrjen në një organizatë terroriste, duke përfshirë furnizimin me informacion ose burime materiale, falsifikimin ose përdorimin e dokumenteve të falsifikuara ose financimin e aktiviteteve të saj në çfarëdo mënyre, duke ditur se një pjesëmarrje e tillë do të kontribuojë në aktivitetet kriminale të organizatës terroriste (Neni 230/a, Neni 232; Neni 234/a)
- Shtimi i një vepre penale që lidhet me provokimin publik për të kryer një vepër penale terroriste, marrjen e trajnimit për terrorizëm, udhëtimin për qëllime terrorizmi, organizimin ose lehtësimin e udhëtimit për qëllime terrorizmi (Neni 232/a; Neni 232/a/1; Neni 232/c; Neni 232/d)

## **5. Transpozimi i *acquis* në lidhje me luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore qeniet njerëzore**

Direktiva 2011/36/BE e 5 prillit 2011 për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të saj, përcakton rregullat minimale për luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore.

Në veçanti, ajo kërkon të

- kriminalizojë trafikimin e qenieve njerëzore në të gjitha format e tij, duke përfshirë shfrytëzimin e prostitucionit ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara përfshirë lypjen ose shfrytëzimin e aktiviteteve kriminale, skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, vënies në përdorim ose transplantimit të organeve shfrytëzimin e bartjes të shtatzënisë për të tretë, martesës të detyruar ose birësimit të paligjshëm, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit;
- të prezantojë rrethana rënduese dhe dënime më të larta, veçanërisht kur vepra penale kryhet kundër fëmijëve, përfshin dhunë të rëndë, rrezikon jetën ose kryhet nga grupe të organizuara kriminale ose zyrtarë publikë;
- të ofrojë mbrojtje dhe ndihmë të shtuar për viktimat, duke siguruar që pëlqimi i tyre të jetë i parëndësishëm kur përdoren mjete shtrënguese, dhe duke dhënë mbrojtje të veçanta për viktimat fëmijë;
- të krijojë juridiksion ekstraterritorial, duke lejuar ndjekjen penale të shtetasve për vepra penale të kryera jashtë vendit, dhe duke forcuar bashkëpunimin ndërkufitar në hetime dhe ndjekje penale.

Amendamentet plotësojnë boshllëqet e mbetura të përafrimit ose rastet e përafrimit të pasaktë, veçanërisht në lidhje me aspektet e mëposhtme (dispozitat të cilat synojnë përafrimin e kërkesave të aktit të BE-së, janë në kllapa):

- Specifikohet që kushti për përgjegjësi penale të njëkohshme në territorin e një shteti tjetër nuk zbatohet në rastet e trafikimit të qenieve njerëzore (Neni 6).
- Lidhur me trafikimin e të rriturve: Përkufizim i zgjeruar për të mbuluar të gjitha format e shfrytëzimit (seksual, punë, praktika të ngjashme me skllavërimin, heqje organesh); Pëlqimi i viktimës konsiderohet i parëndësishëm aty ku përdoret shtrëngimi; Kriminalizohet përdorimi i qëllimshëm i shërbimeve të ofruara nga një viktimë trafikimi kur përdoruesi e di që personi është viktimë e shfrytëzimit (Neni 110/a).
- Lidhur me trafikimin e fëmijëve: Dispozita të forcuara mbi trafikimin e fëmijëve pavarësisht nga pëlqimi; Mbulohet një gamë e gjerë qëllimesh shfrytëzuese: shfrytëzim seksual, punë e detyruar, shfrytëzim zëvendësues, martesë e detyruar, birësim i paligjshëm, lypje dhe kriminalitet i detyruar; Futen forma të rënduara ku akti përfshin dhunë të rëndë ose shkakton pasoja të rënda për jetën, shëndetin ose integritetin psikologjik të viktimës (Neni 128/b).

Sa i takon masës së dënimeve, për veprat e reja penale që shtohen përmes këtij projektligji apo për ato vepra penale për të cilat projektligji parashikon ndryshimin e masës së dënimit theksohet se këto ndryshime janë bërë në mënyrë që të sigurohet përputhshmëria me parashikimet e akteve të BE-së të cilët krahas veprës penale kanë parashikuar dhe masën e dënimit për secilën vepër.

Krahas përmbushjes së detyrimeve që vijnë nga piketat e ndërmjetme, projektligji sjell një sërë përparësish në drejtim të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe mbrojtjen e një sërë marrëdhëniesh shoqërore në mënyrë të përmirësuar. Këto ndryshime synojnë që për këto marrëdhënie shoqërore të zbatohet e njëjta mbrojtje sikundër ajo që zbatohet në Bashkimin Europian.

Efektet e këtyre ndryshimeve lidhen si me ndëshkimin e autorëve të veprave penale, ashtu edhe me efektin parandalues që ka parashikimi i sjelljeve/veprimeve të sipërcituara si vepër penale, duke kontribuar kështu në një shoqëri më të sigurt. Ndër të tjera, përmes shtesave dhe ndryshimeve në Kodin Penal synohet që të arrihet përputhshmëria e dënimeve të parashikuara nga legjislacioni penal kombëtar me ato të parashikuara nga aktet përkatëse të Bashkimit Europian. Këto ndërhyrje synojnë të kontribuojnë, për aq sa është e mundur në parashikime uniforme të dënimeve për vepra të caktuara penale, si dhe në prezantimin e veprave penale të reja njësoj si ato të parashikuara si të tilla në vendet e BE-së

Të gjitha këto sigurojnë një përputhje të plotë me standardet e BE-së në fushën penale, duke shmangur boshllëqet që mund të krijojnë pasiguri juridike dhe duke mundësuar zbatim uniform të tyre.

Krahas përparësive të mësipërme, ndryshimet sjellin rritjen e besueshmërisë ndërkombëtare të vendit pasi përmes tyre Shqipëria forcon kredibilitetin e saj në kuadër të integritetit, duke treguar vullnet dhe kapacitet për të zbatuar detyrimet ndërkombëtare.

Nga ana tjetër këto ndryshime shoqërohen me përfitime ekonomike dhe sociale për Shqipërinë. Zbatimi i legjislacionit të harmonizuar për pastrimin e parave, financimin e terrorizmit ul riskun për tregun bankar dhe rrit besueshmërinë e sistemit financiar shqiptar për investitorët e huaj.

Efektet e pritshme të projektligjit paraqiten si vijon:

---

Relacion shpjegues për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”.

- Dispozitat e reja sigurojnë përputhje me *acquis* dhe krijojnë siguri juridike për aktorët e interesuar.
- Miratimi i projektligjit përforcon mesazhin e Shqipërisë për angazhim të pakthyeshëm në integrimin evropian, duke rritur besueshmërinë ndaj institucioneve të BE-së dhe partnerëve ndërkombëtarë.
- Redukton riskun e përfshirjes së sistemit financiar shqiptar në skema pastrimi parash dhe rrit nivelin e transparencës dhe të kontrollit financiar, duke përmirësuar klimën e biznesit dhe duke ndihmuar në tërheqjen e investimeve të huaja.
- Rrit mbrojtjen e viktimave të trafikimit dhe abuzimit seksual, duke siguruar standarde të barabarta me ato të BE-së dhe duke kontribuar në forcimin e shtetit të së drejtës.

Gjithashtu, ndryshimet e propozuara synojnë të adresojnë një sërë problematikash të evidentuara në praktikë: shtrirja masive e ndërtimeve të paligjshme që dëmtojnë zhvillimin urban e ekonomik të qëndrueshëm; rastet e zënieve të tokës publike që cenojnë interesin e përgjithshëm; si dhe fenomeni i zjarrvënieve të qëllimshme, i cili ka shkaktuar dëme të mëdha në pasurinë natyrore dhe mjedisin.

Fenomenet e ndërtimit të paligjshëm, zënies së tokave dhe zjarrvënieve përbëjnë një problematikë të thellë për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit, integritetin e territorit dhe mbrojtjen e pasurive publike e private. Aktualisht, ndëshkimi penal i këtyre veprimeve rezulton i pamjaftueshëm për të parandaluar përhapjen e tyre masive, duke krijuar pasoja të ndjeshme në planin social, ekonomik dhe mjedisor.

Ndërtimet e paligjshme dhe zënia e tokave publike/ private janë shndërruar në një fenomen të vazhdueshëm që deformon zhvillimin urban, cenon të drejtën e pronës, pengon investimet publike dhe private, si dhe krijon kosto të larta për shtetin në prishje e rikuperim. Akoma më të rënda janë rastet e përfshirjes së funksionarëve publikë në këto shkelje të cilët minojnë besimin e qytetarëve tek institucionet.

Zjarrvëniet e qëllimshme kanë shkaktuar vitet e fundit dëme masive në pyje, parqe natyrore dhe zona të mbrojtura, duke shkatërruar biodiversitetin, trashëgiminë natyrore e kulturore, si dhe duke rritur ndjeshëm kostot për emergjencat civile. Praktika e djegies së qëllimshme të pyjeve për ndryshimin e destinacionit të tokës mbetet një nga format më shqetësuese të abuzimit.

Rreziqet për trashëgiminë dhe infrastrukturën kritike janë shtuar ndjeshëm, pasi ndërtimet e paligjshme apo zjarrvëniet shpesh prekin zona me vlera historike, objekte kulturi, monumente kulturore ose rrjetin e infrastrukturës së vendit.

Prandaj përmes këtij projektligji synohet marrja e masave të menjëhershme të cilat synojnë të ndëshkojnë dhe parandalojnë vijimin me sjellje/veprimet kriminale.

Ndryshimet konkrete paraqiten si më poshtë:

Në nenin 199/a mbi ndërtimet e paligjshme do të shtohen dy paragrafë:

- Aktualisht Kodi parashikon që ndërtimi i kryer pa leje, në shkelje të rëndë të lejes ose në kushtet e një lejeje të shfuqizuar në tokën në pronësi të vet, dënohet me burgim deri në një vit.
- Për herë të parë do të parashikohet një dënim i veçantë kur ndërtimi i paligjshëm kryhet brenda zonave të mbrojtura, parqeve natyrore ose prek objekte të trashëgimisë kulturore, objekte të kulturi, monumente të kulturës apo kur cënon infrastrukturën kritike, i cili do të jetë një dënim me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.
- Ndërkohë për ata punonjës të shtetit apo funksionarë publikë, në ministrinë përgjegjëse për çështjet e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, në Agjencinë e Zhvillimit të Territorit, në Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, në Inspektoratin Kombëtar apo Vendor të Mbrojtjes së Territorit, në Këshillin Qarkut apo atë Bashkiak, në bashki, në Policinë e Shtetit etj., që kanë menduar se roli i tyre është t'u shërbejnë interesave private dhe jo të mirës së përbashkët, kemi një mesazh të qartë: Shtohet një paragraf i posaçëm i cili parashikon dënim me 3 deri në 7 vjet burgim dhe me heqje të së drejtës për të ushtruar funksione publike deri në 5 vjet. Nuk do të ketë më mbrojtje për ata që abuzojnë me pushtetin e tyre.

Neni 200 i Kodit Penal i cili deri më tani parashikon se pushtimi i tokës përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet rikonceptohet plotësisht.

- Ky nen do të emërtohet zënia e pronës dhe do të parashikojë që Zënia e tokës, publike apo private, pa titull ligjor, ndërtimi apo shfrytëzimi të çfarëdollojshëm, kur kryhet për qëllime përfitimi ekonomik apo veprimtarie biznesi, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me burgim deri në dy vjet.

- Kur kjo vepër kryhet në mënyrë të përsëritur, ose në bashkëpunim, ose ka si pasojë pengimin e përdorimit të ligjshëm të tokës nga poseduesi apo pronari, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.
- Po kjo vepër kur kryhet në tokë që ndodhet brenda zonave të mbrojtura, parqeve natyrore ose prek objekte të trashëgimisë kulturore, objekte të kultit, monumente të kulturës apo kur cënon infrastrukturën kritike, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.
- Po kjo vepër kur kryhet nga persona që ushtrojnë funksione publike në fushën e mbrojtjes, zhvillimit, planifikimit, mbikëqyrjes apo kontrollit të territorit, dënohet me burgim nga dy deri në gjashtë vjet dhe me heqjen e së drejtës për të ushtruar funksione publike deri në pesë vjet.

Me ndryshimet që synohet të kryhen në Kodin Penal vëmendje të posaçme ka marrë mbrojtja e pronës vetjake dhe të pasurisë së përbashkët nga pirromanët të cilët i sjellin pasoja shumë të rënda jo vetëm një prone apo individ, por të gjithë shoqërisë shqiptare. Prandaj në projektligj parashikohet shtimi i dy paragrafëve të rinj në nenin 151 të Kodit Penal mbi shkatërrimin e pronës me zjarr.

- Ky nen sipas dispozitave në fuqi përmban disa parashikime ku parashikohet se shkatërrimi apo dëmtimi me dashje i pronës me zjarr dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet. Kur nga vepra penale janë shkaktuar pasoja të rënda materiale, dënohet me burgim gjer në dhjetë vjet. Kur janë shkaktuar pasoja të rënda për jetën e shëndetin e njerëzve, dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.
- Pas këtyre parashikimeve propozohet që të shtohet një ndëshkim me një dënim prej 3 – 8 vjet burgim kur kjo vepër është kryer në një kohë kushtet e motit ose të terrenit rrisin ndjeshëm rrezikun e përhapjes dhe vështirësojnë marrjen e masave për shuarjen e tij apo kur kryhet pranë qendrave ose vendeve të banuara. Gjithashtu, do ketë një dënim nga 4 – 10 vjet burgim kur kjo vepër kryhet brenda zonave të mbrojtura, ose prek objekte të trashëgimisë kulturore, objekte të kultit, monumente të kulturës apo kur cënon infrastrukturën kritike.

Për të shmangur dramat dhe pasojat e rënda në pyjet dhe mjediset pyjore që shkaktojnë shkelësit e ligjit në këto mjedise është ndërhyrë në Kodin Penal për të adresuar edhe këto fenomene. Aktualisht në nenin 206/a mbi shkatërrimin me zjarr të pyjeve dhe mjedisit pyjor, Kodi Penal parashikon se shkatërrimi apo dëmtimi me dashje, me pasoja të rënda materiale, i fondit pyjor, i fidanishtes pyjore, i grumbullit

pyjor ose i çdo njësie të ngjashme me to, me zjarr, dënohet me burgim nga 5 – 8 vjet. Po kjo vepër, e kryer me qëllim ndryshimin e kategorisë dhe destinacionit të tokës, dënohet me burgim nga 5 – 15 vjet. Ndërsa kur ajo ka shkaktuar pasoja të rënda për pronën, shëndetin ose jetën e njerëzve apo shkakton dëme të rënda dhe të zgjatura në kohë ndaj mjedisit apo zonave të mbrojtura, dënohet me burgim nga 10 – 25 vjet.

Krahas këtyre parashikimeve synojmë të shtojmë edhe dy paragrafë sipas të cilëve kur kjo vepër penale kryhet:

- në një kohë kur kushtet e motit ose të terrenit rrisin ndjeshëm rrezikun e përhapjes dhe vështirësojnë marrjen e masave për shuarjen e tij apo kur kryhet pranë qendrave ose vendeve të banuara, dënohet me burgim nga 5 – 8 vjet.
- brenda zonave të mbrojtura, ose prek objekte të trashëgimisë kulturore, objekte të kultit, monumente të kulturës apo kur cënon infrastrukturën kritike, të dënohet me burgim nga 4 – 10 vjet.
- Ndërkohë paragrafi mbi rastet kur vepra penale kryhet me qëllim ndryshimin e kategorisë dhe destinacionit të tokës, ndryshohet duke rritur dënimin me burgim në 7 – 15 vjet, si dhe duke shtuar se në këto raste gjykata vendos që klasifikimi i tokës në zonat e prekura nga zjarri në pyje nuk mund të ndryshohet brenda një periudhe deri në tridhjetë vjet.

As pakujdesia në kryerjen e kësaj vepre penale nuk do të kalojë pa u dënuar në mënyrë që të ndërgjegjësohen të gjithë qytetarët dhe të parandalohen masakrat ndaj mjedisit për shkak të pakujdesisë. Në nenin 206/b mbi shkatërrimin nga pakujdesia me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor do të shtohen dy paragrafë të ngjashëm me ato të mësipërme. Konkretisht:

- Kur kjo kryhet në një kohë kur kushtet e motit ose të terrenit rrisin ndjeshëm rrezikun e përhapjes dhe vështirësojnë marrjen e masave për shuarjen e tij apo kur kryhet pranë qendrave ose vendeve të banuara, dënohet me burgim nga 3 – 7 vjet.
- Kur kjo vepër kryhet brenda zonave të mbrojtura, ose prek objekte të trashëgimisë kulturore, objekte të kultit, monumente të kulturës apo kur cënon infrastrukturën kritike, dënohet me burgim nga 4 – 7 vjet.

Në këtë drejtim, projektakti shoqërohet nga përparësitë e mëposhtme:

**Forcimi i masave ndëshkuese:** Projektligji rrit ndjeshëm shkallën e dënimeve për zjarrvënie dhe ndërtim të paligjshëm, duke krijuar një efekt parandalues më të

fuqishëm. Rastet e zjarrvënieve në kushte që rrisin rrezikun, pranë zonave të banuara ose në zona të mbrojtura, tashmë parashikohen me dënime të rënda deri në 15 vjet burg.

Mbrojtja e pasurive me interes kombëtar: Për herë të parë, parashikohet në mënyrë të qartë mbrojtja penale e zonave të mbrojtura, parqeve natyrore ose objekteve të trashëgimisë kulturore, objekteve të kultit, monumenteve të kulturës apo infrastrukturës kritike nga ndërtimet e paligjshme dhe zjarrvëniet.

Rritja e llogaridhënies së administratës: Dënimet e veçanta për funksionarët publikë që ushtrojnë abuzim me detyrën e tyre në fushën e territorit synojnë të godasin korrupsionin dhe bashkëpunimin e strukturave shtetërore me shkelësit e ligjit.

Garancia për mbrojtjen afatgjatë të pyjeve: Parashikimi që ndalon ndryshimin e destinacionit të tokave të djegura deri në 30 vjet është një mekanizëm i fortë ligjor për të ndalur spekulimin me zjarrvënie të qëllimshme në pyje.

Efektet e pritshme të projektligji janë si më poshtë:

Efekt parandalues: Rritja e dënimeve dhe parashikimi i rrethanave rënduese pritet të ulë ndjeshëm numrin e ndërtimeve pa leje dhe rasteve të zjarrvënieve të qëllimshme. Rritje e besimit të publikut tek shteti: Ndëshkimi i funksionarëve publikë që abuzojnë me pushtetin e tyre do të forcojë ndjenjën e drejtësisë dhe integritetit institucional.

Mbrojtje mjedisore dhe territoriale: Pyjet, zonat e mbrojtura dhe pasuritë kulturore do të kenë një mbrojtje më të fortë ligjore, duke siguruar ruajtjen e biodiversitetit dhe trashëgimisë kombëtare.

Përfitime ekonomike e sociale: Mbrojtja e territorit nga ndërtime të paligjshme krijon kushte për zhvillim të qëndrueshëm urban, turizëm të qëndrueshëm dhe tërheqje investimesh. Ruajtja e pasurive natyrore dhe kulturore sjell gjithashtu përfitime afatgjata për komunitetet lokale.

Në përmbledhje, ky projektakt është i domosdoshëm për të adresuar problematika të përsëritura dhe të dëmshme për territorin e vendit, duke vendosur një balancë mes mbrojtjes së mjedisit, trashëgimisë kombëtare, zhvillimit të qëndrueshëm dhe shtetit të së drejtës.

Sa i takon veprës penale mbi parkimin e dyfishtë që propozohet të shtohet në Kodin Penal, bëjmë me dije se problematikat dhe përparësitë e projektaktit si vijon:

Ndryshimet e propozuara synojnë të adresojnë një sërë problematikash të evidentuara në praktikë: parkimi në rresht të dytë që pengon qarkullimin e automjeteve në shërbim të policisë, zjarrfikësve, autoambulancave dhe shërbimeve të tjera publike; bllokimi i rrugëve dhe pengesat serioze për këmbësorët; si dhe efektet e drejtpërdrejta në rrezikimin e sigurisë publike.

Parkimi i papërshtatshëm dhe pengimi i rrugëve përbëjnë një problematikë të thellë për funksionimin e shërbimeve emergjente dhe qarkullimin e qytetarëve, duke ulur efektivitetin e reagimeve të shpejta dhe duke rritur rrezikun për jetën dhe shëndetin e individëve. Aktualisht, masat ndëshkuese nuk janë gjithmonë të mjaftueshme për të parandaluar këto veprime, duke krijuar pasoja të konsiderueshme në planin social dhe të sigurisë publike.

Veprimet e ndaluara shpesh shndërrohen në një fenomen të përsëritur, që deformon përdorimin e hapësirave publike, cenon të drejtën e qytetarëve për qarkullim të lirë dhe pengon ndërhyrjet urgjente. Rastet kur ndërhyjnë funksionarë publikë ose shërbime të tjera për të adresuar këto shkelje shpesh minojnë besimin e qytetarëve tek institucionet dhe autoritetet lokale.

Përparësitë e projektaktit:

- Forcimi i masave ndëshkuese: Projektligji parashikon gjoba dhe burgim deri në një vit për veprat e parkimit në rresht të dytë duke rritur efektin parandalues dhe duke adresuar përsëritjen e veprimeve të kundërligjshme.
- Rritja e sigurisë publike: Parashikimi i veprimeve që pengojnë shërbimet emergjente garanton që reagimet për zjarre, aksidente apo emergjenca të tjera të jenë më të shpejta dhe më efektive, duke mbrojtur jetën dhe pronën e qytetarëve.
- Mbrojtja e hapësirave publike: Ndëshkimi i parkimeve në rresht të dytë mbështet përdorimin e duhur të infrastrukturës rrugore, duke siguruar kalim të qetë për mjete dhe këmbësorë dhe duke shmangur bllokimet totale të rrugëve.
- Forcimi i efektit parandalues të ligjit: Sanksionet e qarta dhe të rënda synojnë të rrisin ndërgjegjësimin e qytetarëve për respektimin e hapësirave rrugore dhe të kontribuojnë në krijimin e një kulture të përgjegjshme qytetare.

Efektet e pritshme:

- Efekt parandalues: Rritja e gjobave dhe parashikimi i burgimit pritet të ulë ndjeshëm rastet e parkimit të parregullt në rresht të dytë dhe pengimin e qarkullimit emergjent.

- Rritje e besimit të publikut tek institucionet: Zbatimi efektiv i ligjit për ndëshkimin e parkimeve që pengojnë shërbimet emergjente forcon perceptimin e qytetarëve për drejtësinë dhe rendin publik.
- Siguri dhe qarkullim më i mirë: Rrugët dhe hapësirat publike do të jenë më të sigurta dhe më funksionale, duke mbështetur qarkullimin e lirë të qytetarëve dhe veprimet emergjente.
- Përfitime sociale dhe institucionale: Mbrojtja e hapësirave rrugore dhe garantimi i aksesit të mjeteve emergjente kontribuon në një mjedis më të sigurt dhe në forcimin e kulturës së përgjegjësisë civile.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektligji është në përputhje me rendin e brendshëm kushtetues dhe ligjor. Amendimet e propozuara mbështeten në shkronjën “d”, të pikës 2, të nenit 81, të Kushtetutës, ku parashikohet miratimi i kodeve me shumicë të përforcuar (tre të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit) si dhe në pikën 1, të nenit 83, të Kushtetutës. Projektligji është në përputhje me parimin e shtetit të së drejtës, i cili përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit.

Projektligji është në harmoni me legjislacionin e zbatueshëm në fushën e ndërtimit, projektimit, zhvillimit të territorit, inspektimin e ndërtimeve, kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit, shkelja e të cilit passjell përgjegjësi penale, sipas parashikimeve ligjore të propozuara.

#### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)**

Projektakti synon përafrimin me *acquis* të Bashkimit Evropian si më poshtë:

1. Vendimi Kuadër i Këshillit 2001/500/JHA i 26 qershorit 2001 mbi pastrimin e parave, identifikimin, gjurmimin, ngrirjen, sekuestrimin dhe konfiskimin e instrumenteve dhe të ardhurave nga krimi;
2. Vendimi Kuadër i Këshillit 2004/757/JHA i 25 tetorit 2004 që përcakton dispozitat minimale mbi elementët përbërës të veprave penale dhe dënimet në fushën e trafikimit të paligjshëm të drogës;

3. Direktiva 2011/36/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 5 prillit 2011 për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tij, dhe që zëvendëson Vendimin Kornizë të Këshillit 2002/629/JHA;
4. Direktiva 2011/93/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 13 dhjetorit 2011 për luftimin e abuzimit seksual dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografisë së fëmijëve, dhe që zëvendëson Vendimin Kornizë të Këshillit 2004/68/JHA;
5. Direktiva (BE) 2015/849 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 20 majit 2015 mbi parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit, që ndryshon Rregulloren (BE) nr. 648/2012 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, dhe shfuqizon Direktivën 2005/60/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe Direktivën e Komisionit 2006/70/KE;
6. Direktiva (BE) 2017/541 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 15 marsit 2017 për luftën kundër terrorizmit dhe zëvendësimin e Vendimit Kuadër të Këshillit 2002/475/JHA dhe ndryshimin e Vendimit të Këshillit 2005/671/JHA;
7. Direktiva (BE) 2018/1673 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 23 tetorit 2018 për luftën kundër pastrimit të parave me anë të ligjit penal.

Përafrimi i këtyre akteve në Kodin Penal bëhet në mënyrë të plotë për atë sa këto akte përmbajnë parashikime të cilat duhet të përafrohen në këtë Kod.

## **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Projektligji përmban 51 nene si më poshtë:

Neni 1, parashikon ndërhyrjet që bëhen në nenin 6, si më poshtë:

1. Në paragrafin e parë, pas togfjalëshit “shtetas shqiptarë” shtohet togfjalëshi “, tërësisht ose pjesërisht,”.
2. Në paragrafin e dytë, pas fjalës “shqiptar” shtohet togfjalëshi “ose për një shtetas të huaj me rezidencë të përhershme në Republikën e Shqipërisë”.
3. Në paragrafin e dytë, fjalia e dytë ndryshohet si më poshtë:  
“Kushti për dënueshmërinë e njëkohshme në territorin e shtetit tjetër nuk zbatohet në rastet e:  
a. krimeve të korrupsionit në sektorin publik;  
b. ushtrimit të ndikimit të paligjshëm;  
c. të trafikimit të qenieve njerëzore;

ç. abuzimit seksual me fëmijë të mitur, shfrytëzimit seksual të fëmijeve të mitur, shfrytëzimit të prostitucionit me fëmijë të mitur, pornografisë dhe shfaqjeve pornografike me fëmijë.”.

Neni 2, parashikon ndërhyrjet që bëhen në nenin 7, si më poshtë:

1. Në paragrafin e parë, pas fjalës “penale” shtohet togfjalëshi “, tërësisht ose pjesërisht,”.
2. Në paragrafin e dytë togfjalëshi “ose të shtetasit shqiptar” zëvendësohet me togfjalëshin “, të shtetasit shqiptar ose të një shtetasi të huaj me rezidencë të përhershme në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 3 parashikon shtimin e nenit 7/b me përmbajtje si vijon:

“Neni 7/b

Juridksioni në rast refuzimi të ekstradimit për veprat me qëllime terroriste

Ligji penal i Republikës është i zbatuesëm ndaj një shtetasi shqiptar, një shtetasi të huaj ose një shtetasi të huaj me rezidencë të përhershme në Republikën e Shqipërisë që ka kryer një vepër të parashikuar në Kreun VII të pjesës së posaçme të këtij Kodi, kur:

- a) personi është i pranishëm në territorin e Republikës së Shqipërisë; dhe
- b) autoritetet kompetente shqiptare kanë refuzuar të ekstradojnë atë person ndaj një Shteti Anëtar të Bashkimit Evropian ose ndaj një shteti të tretë.

Juridiksioni i parashikuar në këtë nen zbatohet pavarësisht nga vendi ku është kryer ose dyshohet se është kryer vepra.”.

Neni 4, parashikon që në nenin 28, paragrafi i shtatë shfuqizohet.

Neni 5 parashikon që në nenin 30, paragrafi i parë, pas pikës 10 shtohet pika 11 me përmbajtje si vijon:

“11. “Ndalimi i përhershëm ose i përkohshëm i ushtrimit të aktiviteteve profesionale që përfshijnë kontakte të drejtpërdrejta dhe të rregullta me fëmijët e mitur.”.

Neni 6 parashikon se në nenin 45, paragrafi i parë, pas fjalës “shtetërore” shtohet togfjalëshi “organeve publike që ushtrojnë autoritet shtetëror ose organizatave ndërkombëtare publike,”.

Neni 7, parashikon ndërhyrjet që bëhen në nenin 52/a, si më poshtë:

1. Në paragrafin e tretë bëhen shtesat e mëposhtme:

---

Relacion shpjegues për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”.

a) Në fjalinë e parë, pas fjalës “kriminale” shtohet togfjalëshi “që heq dorë nga veprimtaria kriminale” dhe pas fjalës “tyre” shtohet togfjalëshi “u siguron autoriteteve administrative ose gjyqësore informacione të cilat ata përndryshe nuk do të kishin qenë në gjendje t'i siguronin”.

b) Në fjalinë e dytë, pas fjalës “dënimi” shtohet togfjalëshi “, përveç personit që ka kryer njërën nga veprat penale që kanë lidhje me trafikun e lëndëve narkotike dhe psikotrope”.

2. Pas paragrafit të tretë, shtohet paragrafi i katërt, me përmbajtje si vijon:

“Fëmija i mitur i dëmtuar nga veprat penale, që kanë lidhje me shfaqjet pornografike me fëmijë, pornografinë e fëmijëve dhe prostitucionin e fëmijëve, përjashtohet nga dënimi.”.

Neni 8, parashikon ndërhyrjet që bëhen në nenin 100, si më poshtë:

1. Në paragrafin e parë kryhen ndryshimet e mëposhtme:

a) togfjalëshi “kryerja e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale” zëvendësohet me togfjalëshin “përfshirja në akte seksuale”;

b) togfjalëshi “ose me të miturën që nuk ka arritur pjekurinë seksuale”, shfuqizohet.

2. Pas paragrafit të parë, shtohen paragrafi i dytë dhe i tretë, me përmbajtje si vijon:

“Kur përfshirja në akte seksuale me fëmijë të mitur kryhet nga një anëtar i familjes të fëmijës, një person që bashkëjeton me fëmijën, një person që ka abuzuar me një pozicion të njohur besimi, autoriteti ose ndikimi mbi fëmijën, ose kur vepra penale është kryer kundër një fëmije të mitur në një situatë veçanërisht të cenueshme, siç është një fëmijë me aftësi të kufizuara mendore ose fizike, në një situatë varësie ose në një gjendje paaftësie fizike ose mendore, dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet kur fëmija nuk ka arritur moshën katërmëdhjetë vjeç ose me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet kur fëmija është në moshën katërmëdhjetë gjer në tetëmbëdhjetë vjeç.

Shtrëngimi, detyrimi ose kërcënimi i një fëmije të mitur, që nuk ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç, për t’u përfshirë në akte seksuale me një palë të tretë dënohet me burgim jo më pak se dhjetë vjet. Kur kjo vepër është kryer kundër një fëmije të mitur në një situatë veçanërisht të cenueshme, siç është një fëmijë me aftësi të kufizuara mendore ose fizike, në një situatë varësie ose në një gjendje paaftësie fizike ose mendore, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet kur fëmija nuk ka arritur moshën katërmëdhjetë vjeç ose me burgim jo më pak se dhjetë vjet kur fëmija është në moshën katërmëdhjetë gjer në tetëmbëdhjetë vjeç.”.

3. Në paragrafin e dytë, togfjalëshi “marrëdhënia seksuale ose homoseksuale” zëvendësohet me togfjalëshin “përfshirja në akte seksuale” dhe togfjalëshi “me dhunë” zëvendësohet me togfjalëshin “nëpërmjet shtrëngimit, kërcenimit ose dhunës” dhe pas fjalës “shëndetin” shtohet togfjalëshi “apo është rrezikuar jeta e tij”.
4. Në paragrafin e tretë, fjala “vepra” zëvendësohet me togfjalëshin “veprat e parashikuara në paragrafin e parë dhe të tretë të këtij neni”.

Neni 9, parashikon ndërhyrjet që bëhen në nenin 101, si më poshtë:

1. Paragrafi i parë, ndryshohet si më poshtë:

“Përfshirja në akte seksuale, nëpërmjet shtrëngimit, kërcenimit ose dhunës, me fëmijë të mitur dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet kur fëmija nuk ka arritur moshën katërmëdhjetë vjeç ose me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet kur fëmija është në moshën katërmëdhjetë gjer në tetëmbëdhjetë vjeç.”.

2. Pas paragrafit të parë, shtohet paragrafi i dytë me përmbajtje si vijon:

“Shtrëngimi, detyrimi ose kërcënimi i një fëmije të mitur në moshën katërmëdhjetë gjer në tetëmbëdhjetë vjeç, për t’u përfshirë në akte seksuale me një palë të tretë dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.”.

3. Paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë:

“Veprat e parashikuara në paragrafin e parë dhe të dytë të këtij neni dënohen me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet kur kryhen:

a) nga një anëtar i familjes të fëmijës, një person që bashkëjeton me fëmijën, një person që ka abuzuar me një pozicion të njohur besimi, autoriteti ose ndikimi mbi fëmijën, ose kur vepra penale është kryer kundër një fëmije të mitur në një situatë veçanërisht të cënueshme, siç është një fëmijë me aftësi të kufizuara mendore ose fizike, në një situatë varësie ose në një gjendje paaftësie fizike ose mendore;

b) në bashkëpunim, më shumë se një herë ose me dhunë; ose

c) kur i janë shkaktuar fëmijës së dëmtuar pasoja të rënda për shëndetin apo është rrezikuar jeta e tij.”.

4. Në paragrafin e tretë, fjala “vepra” zëvendësohet me togfjalëshin “veprat e parashikuara në paragrafin e parë dhe të dytë të këtij neni”.

Neni 10, parashikon ndërhyrjet që bëhen në nenin 108, si më poshtë:

1. Në paragrafin e tretë, kryhen ndryshimet e mëposhtme:

a) fjala “e qëllimshme” zëvendësohet me togfjalëshin “për qëllime seksuale”;

b) togfjalëshi “apo i një të mituri që nuk ka arritur pjekurinë seksuale” zëvendësohet me togfjalëshin “edhe pa pjesëmarrjen e të miturit në këto akte seksuale”.

2. Pas paragrafit të tretë, shtohet paragrafi i katërt, i pestë dhe i gjashtë me përmbajtje si vijon:

“Përfshirja për qëllime seksuale si dëshmitar i abuzimit seksual, e një të mituri që nuk ka arritur moshën katërmëdhjetë vjeç, edhe pa pjesëmarrjen e të miturit në këto akte seksuale, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga dy deri në gjashtë vjet.”

Veprat e parashikuara në paragrafin e tretë dhe të katërt të këtij neni dënohen me burgim jo më pak se dhjetë vjet kur kryhen:

a) nga një anëtar i familjes të fëmijës, një person që bashkëjeton me fëmijën, një person që ka abuzuar me një pozicion të njohur besimi, autoriteti ose ndikimi mbi fëmijën, ose kur vepra penale është kryer kundër një fëmije të mitur në një situatë veçanërisht të cënueshme, siç është një fëmijë me aftësi të kufizuara mendore ose fizike, në një situatë varësie ose në një gjendje paaftësie fizike ose mendor;

b) me dhunë, në bashkëpunim ose më shumë se një herë, ose

c) kur fëmijës së dëmtuar i shkaktohen pasoja të rënda për shëndetin apo është rezikuar jeta e tij.”

Kur veprat e parashikuara në paragrafin e tretë dhe të katërt të këtij neni kanë sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e fëmijës të dëmtuar dënohen me burgim jo më pak se njëzet vjet.”.

3. Në paragrafin e katërt, togfjalëshi “apo një të mitur që nuk ka arritur pjekurinë seksuale” shfuqizohet.

Neni 1, shtimin e nenit 108/b me përmbajtje si vijon:

“Neni 108/b

Organizimi i udhëtimeve për qëllime seksuale

Organizimi i udhëtimeve për të tjerë, përkundrejtë shpërblimit apo jo, me qëllim kryerjen e ndonjë prej veprave penale të parashikuara në këtë seksion ose në nenet 114, 114/a/1 dhe 117, pavarësisht parashikimeve ligjore përkatëse në vendin për ku organizohet udhëtimi, dënohet me burgim nga dy deri në gjashtë vjet.

Nëse kjo veprimtari kryhet nga personi juridik, gjykata, krahas dënimeve të tjera për të, vendos edhe mbarimin e personit juridik.”.

Neni 12 parashikon ndryshimin e dënimit në nenin 110, paragrafi i parë, togfjalëshi “gjer në një vit” zëvendësohet me togfjalëshin “gjer në dy vjet”.

Neni 13, parashikon ndërhyrjet që bëhen në nenin 110/a, si më poshtë:

---

Relacion shpjegues për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”.

1. Paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

“Rekrutimi, shitja, transportimi, transferimi, fshehja, pritja, ose strehimi i të miturve, duke përfshirë shkëmbimin ose transferimin e kontrollit mbi të miturit, me qëllim shfrytëzimin, dënohen me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet.

Shfrytëzimi do të kuptohet si shfrytëzimi i prostitucionit ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara përfshirë lypjen ose shfrytëzimin e aktiviteteve kriminale, skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, vënies në përdorim ose transplantimit të organeve shfrytëzimin e bartjes të shtatzënisë për të tretë, martesës të detyruar ose birësimit të paligjshëm, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit.”.

2. Pas paragrafit të parë, shtohet paragrafi i dytë dhe i tretë me përmbajtje si vijon:

“Dhënia e pëlqimit nga një viktimë e trafikimit të personave të rritur ndaj shfrytëzimit, qoftë i synuar apo aktual, nuk përbën rrethanë lehtësuese, rrethanë për përjashtimin nga përgjegjësia penale ose dënimi i autorëve të veprës penale të parashikuar në paragrafin parë të këtij neni kur është përdorur një nga mjetet e përcaktuara në atë paragraf.”

Përdorimi i qëllimshëm i shërbimeve të ofruara nga një viktimë e një veprë penale të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, kur viktima shfrytëzohet për të ofruar shërbime të tilla dhe përdoruesi i shërbimeve e di që personi që ofron shërbimin është viktimë e veprës penale në fjalë, dënohet me burgim nga dy gjer në dhjetë vjet.”.

3. Në paragrafin e dytë, pas fjalës “femërore” shtohet togfjalëshi “ose ndaj një personi të rritur me aftësi të kufizuara”.

4. Në paragrafin e katërt, togfjalëshi “shoqërohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike a psikike ndaj të dëmtuarit, për të kryer veprime të ndryshme, sjell pasoja të rënda për shëndetin,” zëvendësohet me togfjalëshin “ose kryhet duke përdorur dhunë të rëndë ose i sjell viktimës pasoja të rënda, duke përfshirë pasoja fizike ose psikologjike”.

Neni 14, parashikon që në nenin 114, paragrafi i dytë, togfjalëshi “me të mitur,” shfuqizohet.

Neni 15, parashikon shtimin e nenit 114/a/1 me përmbajtje si vijon:

“Neni 114/a/1

Shfrytëzimi i prostitucionit me të mitur

Nxitja, rekrutimi, shtrëngimi, detyrimi, ose kërcënimi i një fëmije të mitur për të marrë pjesë në prostitucionin e fëmijëve, ose përfitimi nga ose shfrytëzimi i një

fëmije për qëllime të tilla dënohet me burgim nga dhjetë gjer në pesëmbëdhjetë vjet kur fëmija nuk ka arritur moshën katërmëdhjetë vjeç ose me burgim gjashtë gjer në dhjetë vjet kur fëmija është në moshën katërmëdhjetë gjer në tetëmbëdhjetë vjeç.

Përfshirja në akte seksuale me një fëmijë të mitur i cili përdoret për prostitucion të fëmijëve dënohet me burgim jo më pak se pesë vjet kur fëmija nuk ka arritur moshën katërmëdhjetë vjeç ose me burgim jo më pak se dy vjet kur fëmija është në moshën katërmëdhjetë gjer në tetëmbëdhjetë vjeç.

Veprat e parashikuara në paragrafët një dhe dy të këtij neni dënohen me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet kur kryhen:

a) nga një anëtar i familjes të fëmijës, një person që bashkëjeton me fëmijën, një person që ka abuzuar me një pozicion të njohur besimi, autoriteti ose ndikimi mbi fëmijën, nga persona të ngarkuar me funksione shtetërore dhe publike ose kur vepra penale është kryer kundër një fëmije të mitur në një situatë veçanërisht të cenueshme, siç është një fëmijë me aftësi të kufizuara mendore ose fizike, në një situatë varësie ose në një gjendje paaftësie fizike ose mendor;

b) me dhunë, në bashkëpunim ose më shumë se një herë, ose

c) kur fëmijës së dëmtuar i shkaktohen pasoja të rënda për shëndetin apo është rrezikuar jeta e tij”.

Kur veprat e parashikuara në paragrafët një dhe dy të këtij neni kanë sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e fëmijës të dëmtuar dënohen me burgim jo më pak se njëzet vjet.

Për qëllime të këtij neni, togfjalëshi “prostitucion i fëmijëve” nënkupton përdorimin i një fëmije për akte seksuale ku vlera monetare ose çdo formë tjetër shpërblimi financiar ose shpërblime të tjera jepen ose premtohen si pagesë në këmbim të përfshirjes së fëmijës në akte seksuale, pavarësisht nëse kjo pagesë ose premtim i bëhet fëmijës apo një pale të tretë.”.

Neni 16, parashikon ndërhyrjet që bëhen në nenin 117, si më poshtë:

1. Paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë:

“Prodhimi, importimi, eksportimi, blerja, posedimi, shpërndarja, përhapja, reklamimi, transmetimi, ofrimi, furnizimi ose vënia në dispozicion i pornografisë së fëmijëve të mitur, si dhe aksesimi ose krijimi i aksesit në mënyrë të vetëdijshme në të, me çdo mjet ose formë, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet.”.

2. Pas paragrafit të dytë, shtohet paragrafi i tretë dhe i katërt, me përmbajtje si vijon:

“Përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, për t’i kërkuar një fëmije të mitur për të ofruar pornografi me fëmijë që e përshkruan atë fëmijë, edhe

kur fëmija nuk e ofron pornografinë e kërkuar dënohet me burgim jo më pak se tre vjetë kur fëmija nuk ka arritur moshën katërbëdhjetë vjeç ose me burgim jo më pak se një vit kur fëmija është në moshën katërbëdhjetë gjer në tetëmbëdhjetë vjeç.”

Për qëllime të këtij neni, togfjalëshi “pornografi e fëmijëve” nënkupton çdo material që përshkruan vizualisht:

- a. një fëmijë të përfshirë në sjellje të qartë seksuale reale ose të simuluar,
- b. çdo përshkrim të organeve seksuale të një fëmije për qëllime kryesisht seksuale,
- c. çdo material që përshkruan vizualisht çdo person që duket se është një fëmijë i përfshirë në sjellje të qartë seksuale reale ose të simuluar, apo ndonjë përshkrim të organeve seksuale të çdo personi që duket të jetë fëmijë, për qëllime kryesisht seksuale, ose imazhe reale të një fëmije të përfshirë në akte qartësisht seksuale ose imazhe reale të organeve seksuale të një fëmije, kryesisht për qëllime seksuale.”.

3. Paragrafi i tretë ndryshohet si më poshtë:

“Nxitja ose rekrutimi i një fëmije të mitur për të marrë pjesë në shfaqje pornografike, përfitimi apo shfrytëzimi i një fëmije për qëllime të tilla, marrja pjesë në shfaqje pornografike që përfshijnë fëmijët, ose ndjekja me vetëdije e një shfaqje të tillë dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet kur fëmija nuk ka arritur moshën katërbëdhjetë vjeç ose me burgim nga tre gjer në tetë vjet kur fëmija është në moshën katërbëdhjetë gjer në tetëmbëdhjetë vjeç.”.

4. Pas paragrafit pestë, shtohet paragrafi i gjashtë, i shtatë, i tetë dhe i nëntë me përmbajtje si vijon:

“Shtrëngimi ose detyrimi i një fëmije të marrë pjesë në shfaqje pornografike, ose kërcënimi i një fëmije për qëllime të tilla dënohet me burgim nga dhjetë gjer në pesëmbëdhjetë vjet kur fëmija nuk ka arritur moshën katërbëdhjetë vjeç ose me burgim gjashtë gjer në dhjetë vjet kur fëmija është në moshën katërbëdhjetë gjer në tetëmbëdhjetë vjeç.”

Veprat e parashikuara në paragrafët pesë dhe gjashtë të këtij neni dënohen me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet kur kryhen:

- a) nga një anëtar i familjes të fëmijës, një person që bashkëjeton me fëmijën, një person që ka abuzuar me një pozicion të njohur besimi, autoriteti ose ndikimi mbi fëmijën, ose kur vepra penale është kryer kundër një fëmije të mitur në një situatë veçanërisht të cenueshme, siç është një fëmijë me aftësi të kufizuara mendore ose fizike, në një situatë varësie ose në një gjendje paaftësie fizike ose mendor;
- b) me dhunë, në bashkëpunim ose më shumë se një herë, ose
- c) kur fëmijës së dëmtuar i shkaktohen pasoja të rënda për shëndetin apo është rrezikuar jeta e tij.”

Kur veprat e parashikuara në paragrafët tre dhe katër të këtij neni kanë sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e fëmijës të dëmtuar dënohen me burgim jo më pak se njëzet vjet.”

Për qëllime të këtij neni, togfjalëshi “shfaqje pornografike” nënkupton një shfaqje e drejtuar për një audiencë, duke përfshirë teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, të një fëmijë i angazhuar në sjellje të qartë ose të simuluar seksuale, ose organet gjenitale të një fëmije për qëllime kryesisht seksuale.”.

Neni 17 parashikon ndërhyrjet që bëhen në nenin 128/b si më poshtë:

1. Paragrafi i parë ndryshon si më poshtë:

“Rekrutimi, shitja, transportimi, transferimi, fshehja, pritja, ose strehimi i të miturve, duke përfshirë shkëmbimin ose transferimin e kontrollit mbi të miturit, me qëllim shfrytëzimin, dënohen me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet.

Shfrytëzimi do të kuptohet si shfrytëzimi i prostitucionit ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara përfshirë lypjen ose shfrytëzimin e aktiviteteve kriminale, skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, vënies në përdorim ose transplantimit të organeve shfrytëzimin e bartjes të shtatzënisë për të tretë, martesës të detyruar ose birësimit të paligjshëm, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit.”.

2. Pas paragrafit të parë shtohet paragrafi i dytë dhe i tretë me përmbajtje si vijon:

“Dhënia e pëlqimit nga një viktimë e trafikimit të të miturve ndaj shfrytëzimit, qoftë i synuar apo aktual, nuk përbën rrethanë lehtësuese ose rrethanë për përjashtimin nga përgjegjësia penale e autorëve të veprës penale të parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni kur është përdorur një nga mjetet e përcaktuara në atë paragraf.”

Përdorimi i qëllmshëm i shërbimeve të ofruara nga një viktimë e një veprë penale të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, kur viktima shfrytëzohet për të ofruar shërbime të tilla dhe përdoruesi i shërbimeve e di që personi që ofron shërbimin është viktimë e veprës penale në fjalë, dënohet me burgim nga dy gjer në dhjetë vjet.”.

3. Në paragrafin e tretë, togfjalëshi “apo shoqërohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike a psikike të të dëmtuarit, për të kryer veprime të ndryshme, ” zëvendësohet me togfjalëshin “nëpërmjet përdorimit të dhunës të rëndë ose i sjell viktimës pasoja të rënda, duke përfshirë pasoja fizike ose psikologjike ose rrezikon jetën e tij ”.

Neni 18 parashikon se në nenin 141/a në titull dhe në paragrafin e parë togfjalëshi “mjeteve motorike” zëvendësohet me togfjalëshin “mallrave të vjedhura”

Neni 19 parashikon shtimin e nenit 143/a/8 me përmbajtje si vijon:

“Neni 143/a/8

Mashtrimi që prek interesat financiare të Bashkimit Evropian

Moszbulimi i informacionit në shkelje të një detyrimi specifik, përdorimi ose paraqitja e deklaratave ose dokumenteve të rreme, të pasakta ose të paplota që ka si efekt përvetësimin ose mbajtjen e padrejtë të fondeve nga buxheti i përgjithshëm i Bashkimit Evropian ose buxhetet e menaxhuara nga ose në emër të Bashkimit Evropian, ose keqpërdorimi i fondeve të tilla për qëllime të tjera nga ato për të cilat ato janë dhënë, dënohet me burgim gjer në 5 vjet.

Moszbulimi i informacionit në shkelje të një detyrimi specifik, përdorimi ose paraqitja e deklaratave ose dokumenteve të rreme, të pasakta ose të paplota që ka si efekt zvogëlimin e paligjshëm të burimeve të buxhetit të përgjithshëm i Bashkimit Evropian ose buxhetet e menaxhuara nga ose në emër të Bashkimit Evropiane, ose keqpërdorimi i një përfitimi të përfituar ligjërisht, dënohet me burgim gjer në 5 vjet.

Kur veprat e parashikuara në paragrafin një dhe dy të këtij neni kryhen në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohen me bugim nga dy gjer në gjashtë vjet.

Kur të njëjtat vepra përfshijnë një shumë që tejkalojnë 50000 Euro, dënohen me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.”.

Neni 20 parashikon ndërhyrjet që bëhen në nenin 149/a si më poshtë:

1. Në paragrafin e parë, togfjalëshi “gjer në një vit” zëvendësohet me togfjalëshin “gjer në dy vjet”.
2. Në paragrafin e dytë, Në paragrafin e dytë, togfjalëshi “gjer në dy vit” zëvendësohet me togfjalëshin “gjer në tre vjet”.

Neni 21 parashikon ndërhyrjet që bëhen në nenin 149/b si më poshtë:

1. Në paragrafin e parë, togfjalëshi “gjer në një vit” zëvendësohet me togfjalëshin “gjer në dy vjet”.
2. Në paragrafin e dytë, togfjalëshi “gjer në dy vit” zëvendësohet me togfjalëshin “gjer në tre vjet”.

Neni 22 parashikon se në nenin 151, pas paragrafit të parë shtohet paragrafi i dytë dhe i tretë me përmbajtje si vijon:

“Po kjo vepër e kryer në një kohë kur kushtet e motit ose të terrenit rrisin ndjeshëm rrezikun e përhapjes dhe vështirësojnë marrjen e masave për shuarjen e tij apo kur

kryhet pranë qendrave ose vendeve të banuara, dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet.

Kur kjo vepër kryhet brenda zonave të mbrojtura, ose prek objekte të trashëgimisë kulturore, objekte të kultit, monumente të kulturës apo kur cënon infrastrukturën kritike, dënohet me burgim nga katër deri në dhjetë vjet.”.

Neni 23 parashikon që në nenin 180/a, paragrafi i parë, togfjalëshi “deri në një vit” zëvendësohet me togfjalëshin “deri në dy vjet”.

Neni 24, parashikon se në nenin 199/a, pas paragrafit të fundit, shtohet paragrafi dytë dhe i tretë me përmbajtje si vijon:

“Kur ndërtimi i paligjshëm kryhet nga persona që ushtrojnë funksione publike në fushën e mbrojtjes, zhvillimit, planifikimit, mbikëqyrjes apo kontrollit të territorit, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet dhe me heqjen e së drejtës për të ushtruar funksione publike deri në pesë vjet.

Kur ndërtimi i paligjshëm kryhet brenda zonave të mbrojtura, parqeve natyrore ose prek objekte të trashëgimisë kulturore, objekte të kultit, monumente të kulturës apo kur cënon infrastrukturën kritike, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.”.

Neni 25 parashikon ndryshimin e nenit 200 si më poshtë:

“Neni 200

Zënia e pronës

Zënia e tokës, publike apo private, pa titull ligjor, për qëllime banimi, ndërtimi apo shfrytëzimi të çfarëdollojshëm, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me burgim deri në dy vjet.

Kur kjo vepër kryhet në mënyrë të përsëritur, ose në bashkëpunim, ose ka si pasojë pengimin e përdorimit të ligjshëm të tokës nga poseduesi apo pronari, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

Po kjo vepër kur kryhet në tokë që ndodhet brenda zonave të mbrojtura, parqeve natyrore ose prek objekte të trashëgimisë kulturore, objekte të kultit, monumente të kulturës apo kur cënon infrastrukturën kritike, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Po kjo vepër kur kryhet nga persona që ushtrojnë funksione publike në fushën e mbrojtjes, zhvillimit, planifikimit, mbikëqyrjes apo kontrollit të territorit, dënohet me burgim nga dy deri në gjashtë vjet dhe me heqjen e së drejtës për të ushtruar funksione publike deri në pesë vjet.”.

Neni 26 parashikon ndërhyrjet që bëhen në nenin 206/a si më poshtë:

1. Pas paragrafit të parë shtohet paragrafi i dytë dhe i tretë me përmbajtje si më poshtë:

“Po kjo vepër, e kryer në një kohë kur kushtet e motit ose të terrenit rrisin ndjeshëm rrezikun e përhapjes dhe vështirësojnë marrjen e masave për shuarjen e tij apo kur kryhet pranë qendrave ose vendeve të banuara, dënohet me burgim nga pesë deri në tetë vjet.

Kur kjo vepër kryhet brenda zonave të mbrojtura, ose prek objekte të trashëgimisë kulturore, objekte të kultit, monumente të kulturës apo kur cënon infrastrukturën kritike, dënohet me burgim nga katër deri në dhjetë vjet.”.

2. Paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë:

“Po kjo vepër, e kryer me qëllim ndryshimin e kategorisë dhe destinacionit të tokës, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet. Në këto raste gjykata vendos që klasifikimi i tokës në zonat e prekura nga zjarri në pyje nuk mund të ndryshohet brenda një periudhe deri në tridhjetë vjet.”.

Neni 27 parashikon shtesat pas paragrafit të parë të nenit 206/b si vijon:

“Po kjo vepër, e kryer në një kohë kur kushtet e motit ose të terrenit rrisin ndjeshëm rrezikun e përhapjes dhe vështirësojnë marrjen e masave për shuarjen e tij apo kur kryhet pranë qendrave ose vendeve të banuara, dënohet me burgim nga tre deri në gjashtë vjet.

Kur kjo vepër kryhet brenda zonave të mbrojtura, ose prek objekte të trashëgimisë kulturore, objekte të kultit, monumente të kulturës apo kur cënon infrastrukturën kritike, dënohet me burgim nga katër deri në shtatë vjet.”.

Neni 28 parashikon ndërhyrjet që bëhen në nenin 230 si më poshtë:

1. Në paragrafin parë bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

- a) Fjala “panikut” zëvendësohet me togfjalëshin “një gjendjeje të rëndë frike”;
- b) Pas fjalës “të huaja” shtohet togfjalëshi “ose një institucion apo organizatë ndërkombëtare,”.

2. Në paragrafin e dytë, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

- a) në shkronjën “a”, togfjalëshi “plagosje të rëndë” zëvendësohet me togfjalëshin “dëmtimin e shëndetit fizik ose mendor”;
- b) në shkronjën “ç” shfuqizohet togfjalëshi “apo të një platforme fikse” dhe togfjalëshi “ose platformës fikse”;

- c) në shkronjën “g”, togfjalëshi “pengmarrjen ose rrëmbimin e personit dhe” zëvendësohet me togfjalëshin “pengmarrjen, rrëmbimin e personit ose”;
- ç) në shkronjën “j”, bëhen shtesat dhe ndryshimi i mëposhtëm:
- i) pas fjalës “mbajtjen” shtohet fjala “përdorimin,”;
  - ii) pas fjalës “blerjen” shtohet fjala “furnizimin,”;
  - iii) pas fjalës “biologjike” shtohet fjala “radiologjike,”;
  - iv) togfjalëshi “për prodhimin e armëve të shkatërrimit në masë” zëvendësohet me togfjalëshin “për zhvillimin e armëve kimike, biologjike, radiologjike ose bërthamore”;
- d) në shkronjën “ll” togfjalëshi “me qëllim shkaktimin e vdekjes, ose dëmtimeve të rënda trupore ose me qëllim shkaktimin e shkatërrimeve masive të vendeve, mjediseve ose sistemeve të lartpërmendura” zëvendësohet me togfjalëshin “duke shkaktuar vdekjen, rrezikimin e jetës ose dëmtime të rënda trupore ose duke shkaktuar shkatërrime masive të vendeve, mjediseve ose sistemeve të lartpërmendura”.
- dh) shkronja “m” ndryshon si më poshtë:
- “m) shkatërrimin e rëndë dhe në përmasa të mëdha të pronës shtetërore ose publike, një sistemi transporti, një objekti infrastrukture, duke përfshirë një sistem informacioni, një platformë fikse të vendosur në shelfin kontinental, një vend publik ose pronë private që mund të rrezikojë jetën e njerëzve ose të rezultojë në humbje të mëdha ekonomike”;
- e) pas shkronjës “m” shtohet shkronja “m/1)” me përmbajtje si vijon:
- “m/1) ndërhyrjen e paligjshme në një sistem informacioni apo në të dhënat kompjuterike, kur një akt i tillë është kryer kundër një sistemi informacioni të infrastrukturës kritike duke shkaktuar dëmtime serioze”;
- ë) në shkronjën “n” bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:
- i) togfjalëshi “shkaktimin e ndërprerjes së” zëvendësohet me togfjalëshin “ndërhyrjen ose ndërprerjen e”;
  - ii) pas fjalës “të rëndësishëm” shtohet togfjalëshi “natyror thelbësor, duke rrezikuar jetën e personave”;
- f) pas shkronjës “n” shtohen një shkronjë “nj)” me përmbajtje si vijon:
- “nj) vjedhjen me pasoja të rënda, shtrëngimin me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë si dhe falsifikimin dhe përdorimin e dokumenteve të falsifikuara me qëllim kryerjen e një veprë të parashikuar në këtë nen”;
2. Pas paragrafit të dytë, shtohet paragrafi i tretë me përmbajtje si vijon:
- “Kanosja për kryerjen e veprave me qëllime terroriste të parashikuara në këtë nen dënohet me burgim nga tetë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.”.

Neni 29 parashikon ndërhyrjet që bëhen në nenin 230/a si më poshtë:

1. Pas fjalës “kryer” shtohet togfjalëshi “ose për të kontribuar në kryerjen e”;
2. Togfjalëshi “vepra me qëllime terroriste” zëvendësohet me togfjalëshin “ veprave të parashikuara në këtë Kre”.

Neni 30 parashikon ndërhyrjet që bëhen në nenin 231 si më poshtë:

1. Pas fjalës “kryerjen” shtohet togfjalëshi “ose për dhënien e kontributit në kryerjen”;
2. Pas fjalës “terroriste” shtohet togfjalëshi “, veprave të parashikuara në nenin 234/a të këtij Kodi”;
3. Pas fjalës “ndërkombëtare” shtohet togfjalëshi “por pa qenë e nevojshme që këto vepra të kryhen”;
4. Togfjalëshi “nëse nuk përbën vepër tjetër penale” shfuqizohet.
5. Pas fjalisë së parë shtohet fjalia e dytë me përmbajtje si vijon:  
“Kur kjo vepër synon rekrutimin e fëmijëve, dënimi respektiv shtohet deri në një të dytën e tij.”.

Neni 31 parashikon ndërhyrjet që bëhen në nenin 232 si më poshtë:

1. Pas fjalës “zjarrit” fjala “dhe” zëvendësohet me një presje;
2. Pas togfjalëshit “armëve të tjera”, fjala “dhe” zëvendësohet me fjalën “ose”;
3. Togfjalëshi “njerëzit dhe” zëvendësohet me togfjalëshin “njerëzit, mjedisin ose”;
4. Pas fjalës “kryerjen” shtohet togfjalëshi “ose për dhënien e kontributit në kryerjen”;
5. Pas togfjalëshit “veprimtari të tilla” shtohet togfjalëshi “duke ditur se aftësitë e ofruara synohen të përdoren për këtë qëllim,”;
6. Pas fjalës “ndërkombëtare” shtohet togfjalëshi “dhe pa qenë e nevojshme që këto vepra të kryhen,”;
7. Togfjalëshi “nëse nuk përbën vepër tjetër penale” shfuqizohet;
8. Pas paragrafit të parë shtohet një paragraf i dytë me përmbajtje si vijon:  
“Kur kjo vepër synon stërvitjen e fëmijëve, dënimi respektiv shtohet deri në një të dytën e tij.”.

Neni 32 parashikon se neni 232/a ndryshohet si më poshtë:

“Neni 232/a

Nxitja, thirrja publike dhe propaganda për kryerjen e veprave me qëllime terroriste

“Thirrja, nxitja ose propaganda për kryerjen e veprave me qëllime terroriste ose finiancimin e terrorizmit, kryer nëpërmjet çdo forme komunikimi, shpërndarje apo promovimi të mesazheve, ideologjive apo materialeve që nxitin, inkurajojnë ose glorifikojnë kryerjen e veprave me qëllime terroriste, mbështetjen ose miratimin e tyre, apo promovimin e objektivave, synimeve, apo ideologjisë së organizatave terroriste, duke shkaktuar kështu rrezikun që një ose më shumë vepra të tilla mund të kryhen, por pa qenë e nevojshme që këto vepra të kryhen, dënohet me burgim nga katër deri në dhjetë vjet.”.

Neni 33 parashikon shtimin e neni 232/a/1 si vijon:

“Neni 232/a/1

Marrja e trajnimit për kryerjen e veprave me qëllime terroriste

Marrja e udhëzimeve, njohurive ose aftësive praktike nga një person tjetër për prodhimin ose përdorimin e eksplozivëve, armëve të zjarrit ose armëve të tjera ose lëndëve kimike, bakteriologjike apo bërthamore ose të çdo natyre tjetër, të dëmshme dhe të rrezikshme për njerëzit dhe pasurinë, apo metodave ose teknikave të tjera specifike me qëllim kryerjen ose dhënien e kontributit në kryerjen e një veprë penale me qëllime terroriste, por pa qenë e nevojshme që këto vepra të kryhen, dënohet me burgim jo më pak se shtatë vjet.”.

Neni 34 parashikon shfuqizimin e nenit 232/b

Neni 35 parashikon shtimin e neneve 232/c dhe 232/d me përmbajtje si vijon:

“Neni 232/c

Udhëtimi për qëllime terroriste

Kryerja e udhëtimit, me çdo mënyrë apo mjet, duke përfshirë falsifikimin ose përdorimin e dokumenteve të falsifikuara, nga territori i Republikës së Shqipërisë drejt një shteti tjetër, me qëllim:

a) kryerjen ose kontributin në kryerjen e një veprë penale me qëllime terroriste, sipas nenit 230 të këtij Kodi, pa qenë e nevojshme që këto vepra të kryhen,;

b) pjesëmarrjen në veprimtarinë e një organizate terroriste, sipas nenit 234/a të këtij Kodi, duke ditur se kjo pjesëmarrje do të kontribuojë në veprimtarinë kriminale të kësaj organizate; ose,

c) dhënien ose marrjen e trajnimit për kryerjen e veprave me qëllime terroriste, sipas neneve 232 dhe 232/a1 të këtij Kodi;

përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.

2. Kryerja e udhëtimit, në çdo mënyrë apo mjet, duke përfshirë falsifikimin ose përdorimin e dokumenteve të falsifikuara, drejt territorit të Republikës së Shqipërisë, me qëllim:

- a) kryerjen ose kontributin në kryerjen e një vepre penale me qëllime terroriste, sipas nenit 230 të këtij Kodi, pa qenë e nevojshme që këto vepra të kryhen;
  - b) pjesëmarrjen në veprimtarinë e një organizate terroriste, sipas nenit 230/a të këtij Kodi; ose,
  - c) dhënien ose marrjen e trajnimit për kryerjen e veprave me qëllime terroriste, sipas neneve 232 dhe 232/a1 të këtij Kodi;
- dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.

Neni 232/d

Organizimi ose lehtësimi i udhëtimit për qëllime terroriste

Organizimi, financimi, ofrimi i mjeteve, informacionit, dokumenteve, përfshirë falsifikimin dhe përdorimin e dokumenteve të falsifikuar, mjeteve të transportit apo çdo forme tjetër ndihme që lehtëson udhëtimin e një personi me qëllim kryerjen ose kontributin në kryerjen e një vepre penale me qëllime terroriste sipas nenit 230 të këtij Kodi, por pa qenë e nevojshme që këto vepra të kryhen, pjesëmarrjen në veprimtarinë e një organizate terroriste sipas nenit 234/a të këtij Kodi, ose dhënien apo marrjen e trajnimit për qëllime terroriste sipas neneve 232 dhe 232/a1 të këtij Kodi, duke ditur se kjo ndihmë jepet për një qëllim të tillë, dënohet me burgim nga shtatë deri në dymbëdhjetë vjet.”.

Neni 36 parashikon ndërhyrjet që bëhen në nenin 234/a si më poshtë:

Paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë:

“Pjesëmarrja në një organizate terroriste ose në aktivitetet kriminale të një organizate terroriste, duke përfshirë sigurimin e informacionit ose burimeve materiale, falsifikimin apo përdorimin e dokumenteve të falsifikuar ose duke financuar aktivitetet e saj në çfarëdo mënyre, duke ditur se një pjesëmarrje e tillë do të kontribuojë në veprimtarinë kriminale të organizatës terroriste, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet.”

Neni 37 parashikon shtimin e nenit 244/b me përmbajtje si vijon:

“Neni 244/b

Korrupsioni aktiv i nëpunësve të Bashkimit Evropian

Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt a tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt, për vete ose për persona të tjerë, nëpunësit të Bashkimit Evropian, për

të kryer ose për të mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohen me burgim, nga gjashtë muaj gjer në tre vjet.”.

Neni 38 parashikon shtimin e nenit 245/a me përmbajtje si vijon:

“Neni 245/a

Korrupsion aktiv i funksionarëve të lartë të Bashkimit Evropian

Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, anëtarit të Komisionit Evropian ose të Parlamentit Evropian, për vete ose për persona të tjerë për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohen me burgim nga një deri në pesë vjet.”.

Neni 39 parashikon shtimin e nenit 259/b me përmbajtje si vijon:

“Neni 259/b

Korrupsioni pasiv i nëpunësve të Bashkimit Evropian

Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt a tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt apo i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt, nga nëpunësi i Bashkimit Evropian, për të kryer ose për të mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga dy gjer në tetë vjet.

Nëpunës i Bashkimit Evropian është çdo person i përmendur në Nenin 1 pika (a) e Konventës për luftën kundër korrupsionit që përfshin zyrtarët e Komuniteteve Europiane ose zyrtarët e Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian.”.

Neni 40 parashikon shtimin e nenit 260/a me përmbajtje si vijon:

“Neni 260/a

Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë të Bashkimit Evropian

Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt apo i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt, nga anëtari i Komisionit Evropian ose i Parlamentit Evropian, për të kryer ose mos kryer një veprim që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga katër gjer në dymbëdhjetë vjet.”.

Neni 41 parashikon ndërhyrjet që bëhen në nenin 283 si më poshtë:

1. Në paragrafin e parë bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) Pas fjalës “shitja” shtohet fjala “ofrimi,”;

b) Pas fjalës “tregtimi” shtohet fjala “ndërmjetësimi”;

c) Pas fjalës “dërgimi” shtohet togfjalëshi “dërgimi në transit”;

ç) Pas fjalës “dorëzimi” shtohet togfjalëshi “në çdo formë”.

2. Paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë:

“Po kjo vepër, kur kryhet:

a. në bashkëpunim ose më shumë se një herë;

b. në sasira të mëdha të substancave narkotike dhe psikotrope, si edhe të farërave të bimëve narkotike;

c. me substanca narkotike dhe psikotrope që shkaktojnë dëmtime të rënda në shëndetin e personave ose kanë shkaktuar dëmtime të rënda në shëndetin e personave,

dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.”.

Neni 42 parashikon se në nenin 283/a, paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë:

“Po kjo vepër, kur kryhet:

a. në bashkëpunim ose më shumë se një herë;

b. në sasira të mëdha të substancave narkotike dhe psikotrope, si edhe të farërave të bimëve narkotike;

c. me substanca narkotike dhe psikotrope që shkaktojnë dëmtime të rënda ose që kanë shkaktuar dëmtime të rënda në shëndetin e personave, ose

dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.”.

Neni 43 parashikon se në nenin 284, paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë:

“Po kjo vepër, kur kryhet:

a. në bashkëpunim ose më shumë se një herë;

b. në sasira të mëdha të bimëve;

c. me bimë që shërbejnë ose dihet se shërbejnë për prodhimin dhe nxjerrjen e lëndëve narkotike dhe psikotrope që shkaktojnë dëmtime të rënda në shëndetin e personave ose që kanë shkaktuar dëmtime të rënda në shëndetin e personave,

dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet.”.

Neni 44 parashikon se në nenin 284/c, paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë:

“Po kjo vepër, kur kryhet:

a. në bashkëpunim ose më shumë se një herë;

b. në sasira të mëdha të substancave narkotike dhe psikotrope;

c. me substanca narkotike dhe psikotrope që shkaktojnë dëmtime të rënda në shëndetin e personave ose që kanë shkaktuar dëmtime të rënda në shëndetin e personave, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.”.

Neni 45 parashikon se në nenin 284/ç, bëhen shtesat e mëposhtme:

1. Pas fjalës “tranzitimi” shtohet fjala “, transportimi”;
2. Pas fjalës “tregtimi” shtohet fjala “, shpërndarja”.

Neni 46 parashikon ndërhyrjet që bëhen në nenin 287 si më poshtë:

1. Në paragrafin e parë, bëhen shtesa dhe ndryshimet e mëposhtme:

a) Në shkronjën “a”, bëhen shtesa dhe ndryshimet e mëposhtme:

i) Pas fjalës “saj” shtohet togfjalëshi “ose për të ndihmuar çdo person që është i përfshirë në kryerjen veprës penale për t’iu shmangur pasojave ligjore të veprimeve të tij”;

ii) togfjalëshi “ i veprës” zëvendësohet me togfjalshin “i një veprë”;

iii) togfjalëshi “ose i veprimtarisë kriminale” shfuqizohet.

b) Në shkronjën “b”, togfjalëshi “ose i veprimtarisë kriminale”, shfuqizohet.

c) Në shkronjën “c”, togfjalëshi “ose i veprimtarisë kriminale”, shfuqizohet.

ç) Në shkronjën “d”, togfjalëshi “ose i veprimtarisë kriminale”, shfuqizohet.

2. Në paragrafin e dytë, pas fjalës “profesionale” shtohet togfjalëshi “nga subjekte të legjislacionit në fuqi për pastrimin e parave”.

3. Në paragrafin e katërt, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

a) Pas shkronjës “ç” shtohet një shkronja “ç/1” me përmbajtje si vijon:

“ç/1) vërtetohet se produktet që pastrohen rrjedhin nga një vepër penale, pa qenë e nevojshme të përcaktohen të gjitha elementet faktike ose të gjitha rrethanat që lidhen me atë vepër penale, përfshirë identitetin e personit që e ka kryer veprën.”.

b) Në shkronjën “d”, togfjalëshi “dhe është njëkohësisht e dënueshme, si në shtetin e huaj, ashtu edhe në Republikën e Shqipërisë” zëvendësohet me togfjalëshin “dhe është e dënueshme në Republikën e Shqipërisë”.

4. Pas paragrafit të pestë, shtohet paragrafi i gjashtë me përmbajtje si vijon:

“Dispozitat e këtij neni nuk zbatohen për pasuri që është produkt i veprave penale që prekin interesat financiare të Bashkimit Evropian.”.

Neni 47 parashikon shtimin e nenit 293/1 me përmbajtje si vijon:

“Neni 293/1

Pushimi i mjetit në karrexhatë në rresht të dytë

Pushimi i mjetit në karrexhatë në rresht të dytë, përveç rasteve kur kemi të bëjmë me 2 mjete me pedal, 2 ciklomotorë me dy rrota ose 2 motorë me dy rrota, që pengon qartazi dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë lëvizjen e automjeteve në shërbim të policisë, zjarrfikëseve e të autoambulancave apo shërbimeve të tjera të

institucioneve, bllokun tërësisht rrugën, duke e bërë të pamundur kalimin e mjeteve të tjera ose shkakton bllokim total të rrugës për këmbësorët, duke u bërë pengesë serioze për sigurinë publike përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit.”.

Neni 48 parashikon shtimin e nenit 319/a/1 me përmbajtje si vijon:

“Neni 319/a/1

Korrupsioni aktiv i gjyqtarit të Gjykatës të Drejtësisë të Bashkimit Evropian dhe Gjykatës Evropiane të Auditorëve

Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt a tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt, për vete ose për persona të tjerë, gjyqtarit të Gjykatës të Drejtësisë të Bashkimit Evropian ose Gjykatës Evropiane të Auditorëve, për të kryer ose për të mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohen me burgim, nga një gjer në katër vjet.”.

Neni 49 parashikon shtimin e nenit 319/d/1 me përmbajtje si vijon:

“Neni 319/d/1

Korrupsioni pasiv i gjyqtarit të Gjykatës të Drejtësisë të Bashkimit Evropian dhe Gjykatës Evropiane të Auditorëve

Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt apo i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt, nga gjyqtari i Gjykatës të Drejtësisë të Bashkimit Evropian ose Gjykatës Evropiane të Auditorëve, për të kryer ose mos kryer një veprim që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet.”.

Neni 50 parashikon një dispozitë tranzitore me këtë përmbajtje

Nenet 244/b, 245/a, 259/b, 260/a, 319/a/1 dhe 319/d/1 hyjnë në fuqi në datën e hyrjes në fuqi të ligjit që ratifikon Konventën për luftën kundër korrupsionit që përfshin zyrtarët e Komuniteteve Evropiane ose zyrtarët e Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian.

Neni 51 parashikon hyrjen në fuqi të ligjit 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

## **VII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Ky projektligj është hartuar nga Ministria e Drejtësisë në kuadër të detyrimeve që vijnë si pasojë e piketave të ndërmjetme. Sa i përket ndryshimeve të kryera në kuadër të ndërtimeve pa leje dhe zjarrvënies, parashikimet konkrete janë kryer në vijim të kërkesës së përcjellë nga Ministria e Brendshme.

Propozimet e Ministrisë së Brendshme me shkresën nr. 4650 prot., datë 25.08.2025 janë si më poshtë:

- Lidhur me veprat penale të parashikuara në nenin 199/a të K.Penal (Ndërtimi i paligjshëm), sugjerojmë rritjen e masës së dënimit për të gjitha shkeljet e parashikuara në këtë nen, me qëllim rritjen e efektit parandalues. Ky sugjerim vjen nga konstatimi se shkelësit që kryejnë ndërtim të paligjshëm i konsiderojnë pasojat e kryerjes së veprës penale të papërfillshme në raport me qëllimin e kryerjes së veprës penale.
- Lidhur me veprat penale të parashikuara në nenet 206/a dhe 206/b të K.Penal (Shkatërrimi me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor) dhe (Shkatërrimi nga pakujdesia me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor), sugjerojmë që të kualifikohen në këtë vepër penale çdo zjarrvënie e qëllimshme apo nga pakujdesia pa patur si kriter ardhjen e pasojave të rënda materiale. Ky propozim do të ndikojë në rritjen e efektit parandalues, duke ndërgjegjësuar që çdo zjarrvënie mund të çojë në pasoja të rënda penale.
- Lidhur me zënien e hapësirave publike, si trotuari, rruga, sheshi, kënde lojërash për fëmijë, lulishtja, parku e të tjera të ngjashme, në shërbim të komunitetit, ku menaxhimi mund të jetë publik dhe/ose privat, sugjerojmë shtimin e një parashikimi të posaçëm, ku çdo veprim që sjell zënien e këtyre hapësirave të kualifikohet si vepër penale.

## **VIII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT**

Ngarkohen me zbatimin e këtij projektligji të gjitha institucionet ligjzbatuese..

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Ky projektligj nuk sjell efekte financiare për buxhetin e shtetit.

**MINISTRI**

**ULSI MANJA**